



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 16.05.2022
Dokument Parlamentar

RAPORT

Për shqyrtimin e kandidaturave për zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës së Shqipërisë, në votimin e raundit të parë, datë 16 Maj 2022

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 87 dhe të nenit 88, pika 2/1 të Kushtetutës, në seancën plenare të datës 12.05.2022, njoftoi fillimin e procedurës parlamentare për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vijim të Konferencës së Kryetarëve, e cila në mbledhjen e saj të datës 10.05.2022, me vendimin nr. 9, datë 10.05.2022, vendosi fillimin e procedurës parlamentare për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe caktimin e datës 16 maj 2022, ora 17.00, si datë e zhvillimit të raundit të parë të votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (Komisioni), në zbatim të pikës 2 të nenit 109 të Rregullores së Kuvendit dhe Vendimit nr. 9, datë 10.05.2022 të Konferencës së Kryetarëve, shqyrton në një mbledhje të veçantë, plotësimin e kritereve formale-juridike, të përcaktuara në nenin 86 dhe 87, pika 1 e Kushtetutës për kandidatin/kandidatët e mundshëm të propozuar për President të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni i paraqet raportin seancës plenare sipas afatit të përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, në këtë rast përkatësisht më datë 16.05.2022.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u mbledh më datë 16 maj 2022, ora 10.00, sipas përcaktimeve të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, asnjë kandidaturë nuk është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë.

Në këto kushte, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 87, pika 2 të Kushtetutës, që përcakton se “Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit” dhe “Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat”, i paraqet seancës plenare për informim këtë raport, me qëllim përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të parë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Relator

EDUARD NDRECA

Kryetare

Klotilda BUSHKA